



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2019:088050

Datë: 16.07.2019

Numri i dokumentit: 00410194

PKR. nr. 22/19

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË-Departamenti i Krimeve të Rënda, gjyqtari Nikollë Komani, kryetar i trupit gjykues, me sekretaren juridike Mandushe Doli, në çështjen penale kundër të akuzuarit A.A., Komuna Gjakovë, për shkak të veprës penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 273 par. 1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjakovë PP/I.nr. 77/2018 të datës 08.04.2019, pas mbajtjes së seancës për shqyrtimin e marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë me datë 12.07.2019, në prezencën e prokurorit Ali Uka, të akuzuarit A.A.dhe mbrojtëses së tij F.X. avokate në Gjakovë, me datë 15.07.2019, mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë 16.07.2019 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari **A.A.**, biri i H. dhe N., e gjinisë M., data e lindjes..., Komuna Gjakovë, ku edhe tani jeton, ka të kryer shkollën e mesme, punëtor fizik, i gjendjes së varfër ekonomike, i pa martuar, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, numër personal ...

ËSHTË FAJTOR

Sepse pa autorizim ka poseduar me qëllim shitje substancë narkotike e cila me ligj është shpallur si narkotikë, në atë mënyrë që ditën kritike me datë 07.11.2018 rreth orës 07:00/h, pas një kontrolli dhe bastisje të kryer nga ana e policisë në shtëpinë dhe lokalet përcjellëse të pandehurit, Komuna e Gjakovës, në bazë të një urdhri të lëshuar nga gjykata nën PN.KR.nr. 27/18 të datës 06.11.2018, është gjetur dhe konfiskuar substancë narkotike dhe atë njëmbëdhjetë (11) qese të vogla të mbushura me substancë në formë pluhuri të ngjyrës së bardhë në peshë prej 4.46 gram e llojit kokainë, si dhe një paketim i mbushur me substancë narkotike në formë bari i llojit marihuanë në peshë prej 418.04 gramë, e që nga raporti i ekspertimit i përpiluar nga AKF në Prishtinë me nr. Ref. AKF/2018-3236/2018-3185 e datës 03.04.2019 ka rezultuar të jetë e llojit marihuanë dhe kokainë.

- **me çka ka kryer veprën penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 273 par. 1 të KPRK-së.**

Gjykata në bazë të nenit 6, 7, 17, 41, 43, 45, 46, 73, 74, 75, 76 par. 1 nën par. 1.4, 273 par. 1 të KPRK-së dhe nenit 233 dhe 365 të KPP-së, e:

G J Y K O N

Dënim me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) viti, 7 (shtatë) muajve, si dhe **Dënim** me të gjobë në shumë prej 700,00 €, të cilin dënim është i detyruar ta paguaj në afatin prej 30 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse i akuzuari nuk e paguan dënimin me gjobë, atëherë i njëjti dënim zëvendësohet me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 35 ditëve, duke ja llogaritur 20,00 € për një ditë burgimi.

Detyrohet i akuzuari që ti paguaj shpenzimet e paushallit gjyqësor në shumën prej 100,00 €, si dhe në emër të kompensimit të viktimave të krimit shumën prej 50,00 €, në afatin prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Konfiskohet substanca narkotike e llojit kokainë në peshë prej 4.46 gram, si dhe substanca narkotike e llojit marihuanë në peshë prej 418.04 gramë.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjakovë-Departamenti për Krime të Rënda me aktakuzën PP/I nr. 77/2018 të datës 08.04.2019, ka akuzuar A.A., Komuna Gjakovë, për shkak të veprës penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 273 par. 1 të KPRK-së,

Gjykata ka caktuar seancën për shqyrtimin e marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë ku prezentë kanë qenë prokurori Ali Uka, i akuzuari A.A. dhe mbrojtësja e tij F.X. avokate në Gjakovë.

Prokurori Ali Uka ka theksuar se në shqyrtimin e dytë në këtë çështje penale mbrojtësja e të akuzuarit avokatja F.X., në mënyrë verbale ka parashtruar kërkesë për negocimin e marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë dhe duke u bazuar në këtë kërkesë me datë 09.07.2019 kanë arritur marrëveshjen për pranimin e fajësisë dhe atë për veprën penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 273 par. 1 të KPRK-së. Ka shtuar se të akuzuarit në prezencën e mbrojtëses së tij, i janë sqaruar dispozitat ligjore që kanë të bëjnë me marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë, njëkohësisht është njoftuar i akuzuari për benifitet dhe pasojat e pranimit të fajësisë e për të cilat i akuzuari është pajtuar dhe nuk ka pasur ndonjë vërejtje si dhe i njëjti ka hyr me vullnet të plotë dhe pa presion në marrëveshjen për pranimin e fajësisë, andaj i propozon gjykatës që marrëveshjen për pranimin e fajësisë ta aprovoj.

Mbrojtësja e të akuzuarit, avokatja F.X. ka theksuar se në shqyrtimin e dytë të mbajtur me datë 10.06.2019 kanë bërë propozim në prezencën e gjyqtarit, prokurorit për negocimin e marrëveshjes për pranimin e fajësisë dhe se kjo marrëveshje është bërë me vullnet të plotë, pa ndikim dhe të mbrojturit të saj ja ka shpjeguar pasojat dhe benifitet e marrëveshjes, andaj kërkon nga gjykata që kjo marrëveshje të aprovoj.

I akuzuari A.A. ka theksuar se e pranon në tërësi fajësinë, pajtohet me të gjitha kushtet e arritur në marrëveshjen për pranimin e fajësisë, si dhe me deklaratimet e mbrojtëses së tij.

Gjykata pas dëgjimit të pretendimeve të prokurorit, të akuzuarit dhe mbrojtëses së tij, lidhur me marrëveshjen për pranim të fajësisë ka konstatuar se i akuzuari A.A. e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë sipas marrëveshjes, pranimi i fajësisë mbështet në faktet dhe provat që i janë bashkangjitur aktakuzës, si dhe nuk ekziston asnjëra nga rrethanat për hudhjen e aktakuzës dhe pushimin e procedurës penale të parapara me nenin 253 par. 1 dhe 2 të KPP-së, andaj gjykata ka konstatuar se marrëveshja mbi pranimin e fajësisë ka mbështetje ligjor dhe është e bazuar në nenin 233 par. 21 të KPP-së dhe gjykata ka pranuar marrëveshje për pranimin e fajësisë.

Gjatë seancës për caktimin e dënimit prokurori Ali Uka ka deklaruar se me datë 09.07.2019, kanë arritur marrëveshjen për pranimin e fajësisë me të akuzuarin dhe mbrojtësen e tij dhe se janë të bindur se marrëveshja është arritur me vullnetin e plotë të akuzuarit, si dhe njëkohësisht i akuzuari është pajtuar me dënimet e propozuara, e ku sipas marrëveshjen kanë propozuar që të akuzuarit ti shqiptohet dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) viti, deri në 1 (një) vit, e 8 (tetë) muaj, si dhe dënim me gjobë në shumën prej 500-800,00 € dhe njëkohësisht ndaj të akuzuarit bazuar në nenin 273 par. 5 të KPRK-së, ti shqiptohet dënim plotësues konfiskimi i substancës narkotike të llojit kokainë në peshë prej 4.46 gram, si dhe substancës narkotike të llojit marihuan në peshë prej 418.04 gram.

Mbrojtësja e të akuzuarit, avokatja F.X. ka deklaruar se me datë 09.07.2019 kanë arritur marrëveshjen për pranimin e fajësisë, e cila marrëveshja është bërë me vullnet të plotë, pa ndikim, pas konsultimeve dhe sqarime të mjaftueshme me të mbrojturin e saj, të cilit i janë shpjeguar pasojat dhe përfitimet nga marrëveshja, ashtu që i ka propozuar gjykatës që me rastin e vendosjes lidhur me dënimin në suaza të marrëveshjes së lidhur si rrethana lehtësuese të merret parasysh pranimi për të hyr në marrëveshje i të mbrojturit të saj, gatishmëria e tij që të bashkëpunoi në të gjitha format me organet e drejtësisë, e posaçërisht ta ketë parasysh faktin se i akuzuari deri me tani asnjëherë nuk ka rënë ndesh me ligjin.

I akuzuari A.A. ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë marrëveshjes dhe dënimit të propozuar, si dhe i mbështet deklaratimet e mbrojtëses së tij, duke shtuar se i vjen keq për veprën që e ka kryer dhe premtion se më nuk do të përsërisë vepra penale.

Gjatë marrjes së vendimit mbi dënimin dhe llojit të tij, gjykata ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese të paraparë me nenin 73 dhe 74 të KPRK-së, të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit. Përpos konstatimit të kryerjes së veprës penale në mënyrën, kohën dhe vendin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi nuk ka gjetur rrethana rënduese, ndërsa si rrethana lehtësuese ka marrë parasysh pranimin e fajësisë, pendimin e tij, sjelljen korrekte gjatë seancës, jodënueshmërinë e mëparshme, e të cilat rrethana lehtësuese kanë ndikuar që gjykata ti aplikoi dispozitat e zbutjes së dënimit bazuar në nenin 76 par. 1 nën par. 1.4 të KPP-së, si dhe ta aprovoi marrëveshjen për pranimin e fajësisë, ashtu që të akuzuarit sipas marrëveshjes së arritur ia ka shqiptuar dënimin nën minimumin e përcaktuar ligjor dhe atë dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) viti, e 7 (shtatë) muaj, si dhe dënim me gjobë në shumën prej 700,00, me bindjen e plotë se ky dënim është në harmoni me peshën e veprës penale,

shkallën e përgjegjësisë së të akuzuarit dhe se gjykata është e bindur se me dënimin e shqiptuar ndaj të akuzuarit do të arrihet qëllimi i dënimit nga neni 41 të KPRK-së.

Vendimi mbi konfiskimin e substancave narkotike është marrë bazuar në nenin 273 par. 5 të KPRK-së.

Vendimi për shpenzimet e paushallit gjyqësor në shumën prej 100,00 €, është marrë bazuar në nenin 450 par. 1 dhe 2 nën par. 2.6 të KPP-së, si dhe bazuar në nenin 39 par. 3 nën par. 3.2 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit numër 05/L-036, është marrë vendimi për kompensimin e viktimave të krimit në shumën prej 50,00 €.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË
PKR. nr. 22/19 datë 15.07.2019

Sekretarja Juridike
Mandushe Doli

Kryetari i trupit gjykues-gjyqtari
Nikollë Komani

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej 15 ditësh, llogaritur nga dita e pranimit të tij. Ankesa dorëzohet përmes kësaj gjykate, në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.